

URDHËR
Nr.156/2, datë 11.3.2020

PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË EPIDEMISË NGA INFEKSIONI COVID-19

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 21 pika 1, të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe mospërhapjen e epidemisë nga infeksioni COVID-19,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e gjendjes së epidemisë nga infeksioni COVID-19 deri në një urdhër të dytë.
2. Instituti i Shëndetit Publik dhe të gjithë institucionet e përcaktuara në ligjin 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të zbatojë protokollet specifike për ndërhyrje në situatën epidemie të shkaktuar nga COVID-19.
3. Ngarkohen Instituti i Shëndetit Publik, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori Qendror i Kujdesit Shëndetësor, të gjithë institucionet e kujdesit shëndetësor në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile, organet e qeverisjes vendore të ndërmarrin të gjitha hapat sipas planeve të veprimit në situatë epidemie.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu